ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-24-4459-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Ofrimi i shërbimeve ligjore për nevojat e Komunës së Prizrenit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K.**
NUI	**811398769**
Adresa	**Afrim Bytyqi nr 17**
Vendi	**Prizren**
Kodi postar	**20000**
Numri Telefonit	**+38344584502**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Blerim Mazreku**
Adresa elektronike	**avokatblerimmazreku@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**04.07.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ofrimi i shërbimeve ligjore për nevojat e Komunës së Prizrenit

Ofrimi i shërbimeve ligjore për nevojat e Komunës së Prizrenit

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si kinse e pa bazuar

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i Prokurimit Publik

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 67 - Provat shkresore

Neni 68 - Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Ligji për Avokatinë

Neni 10 - Kushtet për regjistrim

Neni 39 - Humbja e të drejtës për ushtrimin e avokatisë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit (Tutje referuar si: "**Autoriteti Kontraktues**") me datën 07.05.2024 ka hapur aktivitetin e prokurimit me numër 622-24-4459-2-2-1 dhe me titull: "*Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit*".

Në këtë aktivitet të prokurimit kriteret kryesore për dhënien e kontratës ishin*: "Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës (shërbime) duhet të jetë jo ma e vogël se 30.000,00 €. Kërkesa 2 Në kuadër të stafit profesional OE duhet të ketë në përbërje të stafit së paku edhe Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës. Dhe për shkak të natyrës së lëndëve të cilat janë shumica e natyrës civile Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës dhe me gradë shkencore Doktorr i shkencave civile. Vërejtje ME RASTIN E OFERTIMIT TË*

OPERATORËVE EKONOMIK, TË NJËJTIT DUHET TI PËRMBAHEN NENIT 4 PIKA 3 TË RREGULLORES PËR TARIFAT E AVOKATËVE. Ofertuesit të cilët japin çmime në shpërputhje me këto tarifa, shpallen të papërgjegjshëm"

Brenda afatit të paraparë me dosjen e tenderit Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K. (Tutje referuar si: "**Parashtruesi i Ankesës**") ka dorëzuar ofertën me të gjitha dokumentet mbështetëse dhe dëshmitë siç janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Me datë 20.06.2024 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Dokumentin B58 Njoftimin për Vendimin e Autoritetit Kontraktues (Tutje referuar si: "**Vendimi i Kontestuar")** me të cilin kemi kuptuar se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar anulimin e aktivitetit të prokurimit, kinse për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme. Parashtruesi i Ankesës menjëherë ka dorëzuar Kërkesë për Rishqyrtim përmes të cilës ka argumentuar se oferta e tij është e përgjegjshme dhe se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit dhe rrjedhimisht nuk ka kushte për anulim të aktivitetit të prokurimit. Me datën 26.06.2024 Autoriteti kontraktues ka nxjerr vendim me të cilin pa asnjë arsyetim të qëndrueshëm ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si kinse të pabazuar.

Çmimet sipas Rregullores për Tarifa të Odës së Avokatëve të Kosovës: Parashtruesi i Ankesës të gjitha çmimet e ofruara i ka në përputhje të plotë me Rregulloren e Odës së Avokatëve të Kosovës në fuqi në lidhje me këto tarifa. Siç përcaktohet në rregullore, përkatësisht në nenin 3 dhe 4, Parashtruesi i Ankesës i ka përshtatur të gjitha çmimet, në atë mënyrë që të ketë përshtatshmëri të plotë me Rregulloren. Për më tepër, Parashtruesi i Ankesës për të qenë 100 përqind i sigurt ka marrë edhe një konfirmim nga ana e Odes se këto çmime janë në përputhje me Rregulloren e Odës së Avokatëve të Kosovës për Tarifat e Avokatit. Andaj ky pretendim i Autoritetit Kontraktues nuk ka asnjë mbështetje në fakte apo në rregullore. Për më tepër në arsyetim të vendimit për eliminim nuk përmendet asnjë arsye konkrete se cili pozicion është në kundërshtim me Rregulloren e Odës për Tarifat. Përderisa nuk ekziston një arsyetim i tillë, Autoriteti Kontraktues duhet që të pranoj këtë kërkesë për rishqyrtim. Autoriteti kontraktues në rast se ka pasur dilema në lidhje me çmimet, ka mundur që të kërkoj sqarime nga ana e Odës së Avokatëve e cila ka për obligim ti përgjigjet në rastet e tilla.

Gabimet aritmetike: Parashtruesi i Ankesës ka plotësuar paramasën në përputhje të plotë me formatin e Autoritetit Kontraktues dhe fakti se nëntotalin nuk e ka kalkuluar tek tabela kryesore, por atë e ka vendosur tek rikapitulimi, nuk paraqet asnjë shkelje ligjore dhe nuk përbën gabim aritmetikor. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka identifikuar gabim aritmetikor në kalkulim të ofertës financiare, atëherë do të duhej që ta sqaronte një gjë të tillë, cili pozicion qenka kalkuluar gabimisht. Përderisa gabimet aritmetikore nuk kanë sqaruar nga Autoriteti Kontraktues, Parashtruesi i Ankesës e ka edhe të vështirë të jap sqarime të duhura, mirëpo Parashtruesi i Ankesës garanton se e gjithë oferta financiare

është pa të meta dhe se do ti përmbahet në përpikmëri çmimeve të ofruara në ofertë financiare në rast se i njëjti shpërblehet me kontratë. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik neni 59, paragrafi 3 thuhet: "*Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla*." Në rastin përkatës në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe në arsyet e eliminimit, nuk përmendet asnjë gabim konkret në paramasën e parashtruesit të ankesës. Nga ana e ekspertit shqyrtues apo panelit kërkojmë që zyrtarisht të kërkoj informata nga Oda e Avokatëve të Kosovës nëse këto tarifa janë apo jo në përputhje me Rregulloren e Odës së Avokatëve për Tarifat.

laj, duke marrë në konsideratë të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara më lartë, me respekt i kërkojmë Panelit Shqyrtues që pas shqyrtimit të kësaj Ankese të nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e operatorit ekonomik Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku.

II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 20.06.2024 dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N/a

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*